




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Nr. 157/24  
Data. 23.02.24



Prishtinë, 29 janar 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1873\_2024

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 pika 1.2 dhe paragrafi 7 nënpar. 7.2, Nenin 25 dhe Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 25/ 14 Korrik 2016,Prishtinë));
- Dispozitat e Nenit 22 par. 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr. 26/ 21 Korrik 2016,Prishtinë);
- Dispozitat e Nenit 5 të Rregullës Nr. 04/2020 për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Kryerjen e Aktiviteteve të Ndërlidhura me Bashkimin e Tregut dhe Operimin e Tregut të Bashkuar;
- Vendimin V\_1748\_2023 të datës 17 korrik 2023 për aprovimin e kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A., dhe përcaktimin si Operator i Emëruar i tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për kryerjen e Aktiviteteve të ndërlidhura me bashkimin e tregut të një dite para dhe ndërditor dhe Operimin e Tregut të Bashkuar për territorin e Republikës së Kosovës;
- Vendimin V\_1833\_2024 të datës 29 janar 2024 për aprovimin e kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A., për fillimin e tregtimit të Një Dite Para për Zonën Tregtare të Republikës së Kosovës, e cila do të përkoj me ditën e fillimit të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës.
- Rekomandimin e Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) i mbledhjes së datës 24.04.2019;
- Kërkesën e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A.- mbi Caktimin e Rolit të Agjentit të Transferimit (“shipping agent”) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë. Nr. 556/23 të datës 01.12.2023;

**në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET – kërkesa e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX SH.A., mbi Caktimin e Rolit të Agjentit të Transferimit (“shipping agent”) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë.**



## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: ZRRE) me datë 01.12.2023 nga shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A. ka pranuar Kërkesën mbi Caktimin e Rolit të Agjentit të Transferimit (shipping agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë.
- Shoqëria Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX SH.A., në kërkesën e saj ka theksuar se:
- Në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra nga Marrëveshja Kornizë Nr 456/21 e datës 21.10.2021, Mbi Bashkimin e tregjeve të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, e nënshkruar ndërmjet ERE, ZRRE, OST dhe KOSTT, janë duke bashkëpunuar në lidhje me bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike, një ditë para, Shqipëri-Kosovë.
- Rregulla Nr. 04/2020 për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar ka përcaktuar rolin e Agjentit të Transferimit që ka për detyrë transferimin e neto pozicioneve në mes Palëve të ndryshme.
- Po ashtu në Nenin 5 par. 2.10 të Rregullës Nr. 04/2020 është përcaktuar se NEMO të kryej rolin e agjentit të transferimit nëse vendoset nga ZRRE. Ndërsa me Nenin 6 par. 2.11 në lidhje me tregun e bashkuar një ditë para dhe atij ndërditorë” përcaktohet se: Detyrat që KOSTT do të kryej janë që të kryej rolin e agjentit të transferimit, nëse është vendosur nga Rregullatori.
- Në Rekomandimin e dhënë nga Bordi i Rregullatorit të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në mbledhjen e datës 24.04.2019, e cila është marrë në konsideratë nga ZRRE me Rregullorën Nr. 04/2020, është shprehur se: “ Zakonisht agjentë Transferimi janë NEMO, por është gjithashtu e mundur që OST-të ta kryejnë këtë aktivitet në përputhje me Nenin 8(1) të Rregullores CACM. Për më tepër, në përputhje me Nenin 68 (6) të Rregullores CACM, një agjent transferimi mund të veproj si kundërpalë ndërmjet palëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim. Për palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë rekomandohet gjithashtu t’i referohen një NEMO për tu përafuar me dispozitat e Rregullores CACM.
- ZRRE me datë 26.01.2024 nga Komiteti Drejtues për Qeverisjen e Bashkimit të Tregjeve të Energjisë Elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, ka pranuar Vendimin për caktimin e ditës së fillimit të bashkimit të tregjeve të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, me të cilën është vendosur fillimi i bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës që të jetë Njësia Kohore e Tregut të Një dite Para që i përket orës 00:00 të datës 01.02.2024 sipas Kohës Lokale.
- Sipas Vendimit të Komitetit Drejtues është vendosur që Vendimi në fjalë do të hyn në fuqi pasi që Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës të ketë konfirmuar me Vendimin përkatës hapjen e Tregut të Një Dite Para për Zonën e Ofertimit të Kosovës.




- o ZRRE gjithashtu me Vendimin V\_1833\_2024 ka vendosur për Fillimin e Tregtimit të Tregut të Një Dite Para të ALPEX SH.A. për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.
- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX SH.A mbi Caktimin e Rolit të Agjentit të Transferimit (shipping agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Burgaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adrian Preniqi, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- ALPEX,
- KOSTT sh.a, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.